

Ligj
Nr. 49/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 142, DATË 15.5.2009,
“PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE
TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS
SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË AGJENCISË
SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES, TË POLICISË SË
BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në titull dhe kudo në përmbajtjen e ligjit emërtimi “Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit” zëvendësohet me emërtimin “Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi” dhe emërtimi “Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm” zëvendësohet me emërtimin “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Neni 2

Në nenet 1 dhe 3, pika 1, togfjalëshat “ nr. 8766, datë 5.4.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe nr. 10 002, datë 6.10.2008, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”” zëvendësohen me togfjalëshat “ nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi” dhe nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore””.

Neni 3

Në shkronjën “a” të pikës 4 të nenit 12 pas emërtimit “Policia e Burgjeve” shtohen emërtimet “Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi” dhe “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.6.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 100, datë 5.7.2023, të Presidentit të Republikës Së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**